



Bisedë me Dr.Fadil Malokun, Nënkryetar I AKR

Titulli: **AKR synon të instaloj konceptin e ri të funksionimit të vendit**

MALOKU: Për dallim nga tani, konsiderojmë të ndërtojmë një shtet me një sistem liberalo - demokratik ku qytetari do të jetë pjesëmarrës aktiv në jetën politike, pasi demokracia jeton nga pjesëmarrja e qytetarit në shoqëri dhe në shtet.

Kosova Sot: Cfarë ju ka motivuar të braktisni shoqërin civile dhe të kyqeni në jetën politike?

Maloku: Kjo është një pyetje që vazhdimisht më bëhet dhe unë vetëm po e rikonfirmoj se motiv ka qenë paknaqësia totale me rrjedhat politike që aktualisht kanë ndodhur në Kosovë në periudhën e pasluftës. Kjo më intrigon për proceset e reja që do të pasojnë pas statusit dhe elementi më fuqizues është koncepti I ri të cilin kryetari Behxhet Pacolli mëton ta instalojë në rrjedhat e reja politike pas statusore.

Kosova Sot: Më herët keni mbështetur ide të ndryshme të cilat kanë reflektuar me koncepte të partive të tjera. Pse pikërisht në AKR?

Maloku: AKR në periudhën që po hyjmë do t'ia ofrojë shoqëris kosovare një koncept të ri për dallim prej ofertave të partive të tjera deri tani. Mendoj se është një koncept I ri në kuptimin që vjen prej një branshe ku prioritet do të jenë zhvillimet ekonomike, ku ato do të jenë favorizuese për mirëqenien e qytetarëve. Për dallim nga tani, konsiderojmë të ndërtojmë një shtet me një sistem liberalo - demokratik ku qytetari do të jetë pjesëmarrës aktiv në jetën politike, pasi demokracia jeton nga pjesëmarrja e qytetarit në shoqëri dhe në shtet. Deri tani që qytetari nuk ka qenë I fuqizuar sa duhet dhe pjesëmarrës I proceseve dhe zhvillimeve politike që kanë ndodhë në periudhën e pasluftës si pasojë e diktimit të këtyre proceseve nga një grup I vogël njerëzish të cilët më tepër kanë mbrojtur intereset klanore, partiake se sa ato të përgjithshme. Në periudhën që po hyjmë kjo do t'i dëmtojë mjaft shumë këto parti politike. Per dallim nga ato AKR në periudhat e ardhshme do të jetë një urë lidhëse mes

qytetarit dhe shtetit, pra do të vëhet në shërbim të qytetarit e jo këta të fundit në shërbim të partis.

Kosova Sot: Ne kuvendin e fundit zgjedhor ka pasur disa lëvizje të figurave brenda parties. Si I konceptoni këto lëvizje?

Maloku: Mendoj se në kuvendin zgjedhor kemi dalë më të fuqishëm duke pasur parasysh numrin e madhë të ekspertëve të fushave të ndryshme. Në këtë kuadër në kuvendin e fundit janë ndarë detyrat dhe është bërë ndarja e përgjegjësive nëpër departamente. Në këtë drejtim AKR shprehet për një sistem të pastër presidencial. Pra që presidenti të zgjidhet drejtpërsëdrejti nga ana e popullit me mandat 4 vjeçar dhe të drejtë rizgjedhjeje. Aktualisht diskursi politik është një rreth vicioz ku ne mendojmë se duhet ridizjnuar strukturën organizative të aparatit shtetëror. Në këtë drejtim mendojmë se duhet të ketë një reduktim të ministrive nga 13 në gjashtë ministri. Pra të një administrate të vogël të efektshme dhe modifikuar në bazë të kërkesave të tregut dhe eliminimit të keqpërdorimeve të ndryshme. AKR synon të instalojë një koncept të ri ku përgjegjësia do të jetë drejtpërdrejt, pa konsultime të subjekteve të ndryshme. Kjo është një risi dhe AKR nuk premtan por garanton.

Kosova Sot: Nuk do të ishte ngarkesë për bugetin mbajtja e tri palë zgjedhjeve, marrë parasysh konceptin e AKR për zgjedhjet presidenciale?

Maloku: Jo, kujtojmë se nuk do të rritë shpenzimet e bugetit. Ky sistem është mjaft funksional nga praktika e SHBA apo Francë ku kemi një sistem gjysëpresidencial. Kosovës nuk i duhen 13 ministri duke pasur parasysh implikimet buxhetore por edhe keqpërdorimet e mëdha.

Kosova Sot: Sa do të jetë kjo premtuese për AKR duke qenë që Ekipi I Unitetit tashmë është dakorduar që pragu zgjedhor të jetë prej 5 përqind. Keni shqyrtuar mundësin e koalicionit me ndonjë nga subjektet e spektrit politik të vendit?

Maloku: Për ne pragu zgjedhor nuk është problem pasi synojmë arrijten e shumicës absolute dhe ky është objektivi ynë. Kjo pyetje më tepër do të duhej adresohet partive të vogla. Mirëpo kujtoj se në një vend me dy milion banorë të ketë 30 parti politike është një paradoks i llojit të vet. E logjikshme do të ishte që Kosova gradualisht të ashpërsoj kriterin e pragut zgjedhor, që partit të cilët dëshirojnë të jenë pjesë e ndërtimit të një mirëqenie të re ekonomike të kenë përgjegjësi. Kështu që ashpërsimi i kriterit për pragun zgjedhor dhe reduktimi i administratës prej 13 në 6 ministri dhe fuqizimi i demokracisë ekonomike krahas demokracisë politike, konsiderojmë se është një model i rëndësishëm për të dalë Kosova prej një

mantaliteti ku nuk ka rregulla dhe ku nuk sundon ligji.

Kosova Sot: A keni menduar për koalicione?

Maloku: Synimi jonë është që ta formojmë qeverin vet, por kjo asnjëherë nuk përjashton kontaktet dhe bashkëpunimin me partit tjera, pa dallim.

Qëllimi ynë është që të ndërtojmë një shoqëri ku qytetari do të jetë në epiqendër të vëmendjes. Në kushtetutën e ardhshme konsiderojmë që Kosova duhet të jetë një shoqëri qytetare, pa dallime të përkatësive qoftë politike, religjioze, etnike apo racore. Prandaj fuqizimi i demokracisë ekonomike krijon paradispozita për ndërtimin dhe fuqizimin e demokracisë politike. Ky është një front i përgjithshëm ku të gjitha shtresat do ta kenë mundësinë që të kyqen në projektin për ndërtimin e vendit dhe mirëqenies sociale.

Kosova Sot: Thatë më herët se partit tjera kanë dështuar në implementimin e programeve të veta. Si do të përmbushni ju premtimet në fakt cila është fuqia reale në kohë dhe hapësirë e AKR për përmbushjen e këtyre premtimeve?

Maloku: Mos të harrojmë se në zgjedhjet e mëhershme mbi 50 për qind të elektoratit nuk kanë votuar shkaqet janë të arsyeshme. Ky është një potencial i rëndësishëm për zhvillimet e ardhshme në të cilin llogarisim përfshirë këtu edhe kontigjentin e votuesve të paknaqur nga qeverisja aktuale. Koncepti të cilën e ka lançuar vetë kryetari i partisë Behxhet Pacolli vë në një moment mjaft të rëndësishëm si rrjedhojë e paknaqësis sociale. Adhja e një njeriu që është dëshmuar në arenën ndërkombëtare si menaxhues i kompanis transnacionale është një ofertë mjaft serioze ku nuk nuk ipen premtime por me rëndësi garantohet në fazë afatshkurta, afatmesme, afatgjate. Ne kemi projekte për shtresa të ndryshme të qytetarëve. Faktikisht do të synojmë që qeveria e këtij subjekti të jetë qeveri e ekspertëve.

Ilir KRASNIQI

Foto: Ilir KRASNIQI